

EDMOND MALAJ

MARRËDHËNIET TREGTARE NDËRMJET RAGUZËS DHE SHQIPTARËVE GJATË PERIUDHËS OSMANE NËN DRITËN E DISA AUTORËVE

Rezultatet e para të një hulumtimi

Abstrakt:

Artikulli synon të jetë si hyrje e shkurtër në studimet rreth marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve dhe Republikës së Raguzës gjatë periudhës osmane. Në artikull trajtohen shkrime të botuara nga autorë të ndryshëm, të cilat kanë një rëndësi të veçantë në lidhje me historinë e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Raguzës dhe shqiptarëve kryesisht gjatë shek. XVI-XVIII. Artikulli paraqet disa rezultate paraprake në lidhje me kërkimin, gjurmimin dhe gjetjen qoftë të dokumenteve, qoftë të punimeve të ndryshme. Këtu po paraqesim disa autorë të rëndësishëm të kësaj teme studimore, pjesa më e madhe e këtyre studiuesve janë sllavë, kryesisht kroatë. Ndër emrat e rëndësishëm të këtyre studiuesve mund të përmendim Josip Luetić, Vuk Vinaver, Bogomil Hrabak, Vinko Ivančević etj. Në artikull synohet të jepen qasjet kryesore që autorët në fjalë i bëjnë kësaj teme në këta artikuj.

Fjalë kyçe:

Republika e Raguzës, Perandoria Osmane, Vlora, Shkodra, Lezha, tregtia detare, hebrenj, raguzanë, marina tregtare.

Hyrje

Mbas disa vitesh hulumtime, duke u përqendruar veçanërisht në marrëdhëniet shqiptaro-raguzane gjatë Mesjetës, dhe si rrjedhojë e të cilave u botuan disa artikuj në lidhje me këto marrëdhënie¹, erdhi çasti që

¹ Edmond Malaj, “Marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare ndërmjet Raguzës dhe trojeve arbërore”, në *Studime historike*, nr. 1-2, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2021; “Kastriotët dhe Raguzë”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2020; “Mjeshtërit dhe

ta shtrijmë hulumtimin tonë përtej Mesjetës, në një fazë të dytë, që konsiston në marrëdhëniet shqiptaro-raguzane gjatë periudhës osmane, duke u bazuar kryesisht në ato tregtare. Mallrat ashtu si në Mesjetë janë pothuajse të njëjtat edhe në periudhën e sundimit osman. Ndër dokumente të shumta bie në sy tregtia e drithit, e cila blihej nga raguzanët në shumë lokalitete shqiptare dhe ngarkohej pothuajse në të gjitha portet dhe limanet shqiptare. Po ashtu, edhe lëkurët dhe leshi janë produkte të shpeshta. Nuk mungojnë as dylli, peshku i thatë dhe sera. Më poshtë po japim një paraqitje qoftë tematike, qoftë kronologjike të aktiviteteve tregtare në lidhje me këto produkte.

Marrëdhëniet tregtare dhe ekonomike ndërmjet trojeve shqiptare dhe Republikës së Raguzës vazhduan edhe pas pushtimit osman, sepse duke i paguar Perandorisë Osmane taksën e haraçit, Republika e Raguzës pati konsensusin e kësaj perandorie që nga shek. XV, kur osmanët i pushtuan trojet shqiptare e deri në fillim të shek. XIX (ose më saktë deri në vitin 1806) që shënon edhe fundin e kësaj republike me ardhjen e francezëve dhe të Napoleonit.²

Studime me rëndësi primare

Në këtë pjesë të parë të artikullit kemi radhitur disa artikuj e punime të cilat përbëjnë peshë në këto studime dhe që autorët e tyre kryesisht me origjinë nga ish Jugosllavia, janë akoma edhe sot e kësaj dite mjaft të panjohur për lexuesin shqiptar (bëjnë përjashtim këtu shqiptarët e Kosovës). Këta autorë janë: Josip Luetić, Vuk Vinaver, Bogumil Hrabak, Vinko Ivančević etj.

Me një rëndësi shumë të madhe në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet Raguzës dhe Shqipërisë osmane, duke u përqendruar kryesisht te lundrimet tregtare janë edhe punimet e studiuesit kroat Josip Luetiq, të cilit në këtë artikull po i kushtojmë një hapësirë të veçantë. Në lidhje me

zejtarët shqiptarë në Raguzë gjatë Mesjetës”, *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2020; “Prania dhe veprimtaria e klerit shqiptar në Raguzë gjatë Mesjetës”, *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2019; “Klerikët shqiptarë në shërbim të pelegrinazheve në Raguzën mesjetare, sipas disa dokumenteve”, *Hylli i Dritës*, nr. 2, Shkodër: 2020; “Në gjurmë të familjeve fisnike raguzane me origjinë nga trojet shqiptare”, *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2019.

² Alvin Saraçi, *Tregtia adriatike e Shkodrës me Republikën e Venecies në shekujt XVII dhe XVIII*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2018, f. 151.

Josip Luetiq (Josip Luetić *1920 - †2005)³ mund të themi që ai ishte një ndër specialistët më të rëndësishëm kroatë të kohëve të fundit, i cili u mor me studimet e botës detare të qytetit të Dubrovnikut, duke u përqendruar në marrëdhëniet ekonomike dhe në tregtinë detare. Ai ka qenë drejtor i Muzeut Detar të Akademisë së Shkencave të Jugosllavisë, dhe në hulumtimet e tij që merren kryesisht me ekonominë detare të Republikës së Raguzës për periudhën ndërmjet viteve 1603-1803, ishte studiuesi i parë që përcaktoi rëndësinë e marinës tregtare të kësaj republike dhe e vendosi atë, qoftë në kuadrin mesdhetar, qoftë në atë të historisë botërore. Ai ishte një njohës i mirë edhe i anijeve të asaj periudhe dhe bëri përcaktime të sakta në lidhje me anijet e përdorura gjatë asaj kohe, sidomos ato që i përkisnin detarisë kroate.

Gjatë hulumtimeve tona arritëm të siguronim disa artikuj të këtij studiuesi, si p.sh. ato me titull “Republika e Raguzës si fuqi detare me një vështrim të veçantë të marrëdhënieve tregtare italo-shqiptare.” (*Die Republik von Ragusa als Seemacht mit besonderer Berücksichtigung der italienisch-albanischen Handelsbeziehungen*)⁴; “Lundruetit detarë, marina tregtare dhe veprimtaria e porteve të Vlorës, Durrësit dhe Lezhës dhe lidhjet nautike-komerciale të shqiptarëve me dubrovnikasit në vitet 1566-1584”⁵ e botuar në gjuhën kroate me një zgjerim prej më shumë se dy vjetësh, nën titullin “*Moreplovci, trgovačka mornarica i lučka djelatnost Valone, Drača i Lješa i nautičko-komercijalne veze Albanaca s Dubrovčanima 1566-1586. Godine*”⁶; më tej “Lundruetit detarë, marina

³ Të dhënat biografike janë marrë nga: “Glavni urednik: In Memoriam Josip Luetić, Ph. D. (1920. – 2005.)”, në *Naše more* 52(1-2), Dubrovnik: 2005, f. 98-99. Artikulli i botuar me rastin e vdekjes së Josip Luetić, në këtë revistë kryeredaktor i së cilës ishte ai vetë.

⁴ Josip Luetić, “Die Republik von Ragusa als Seemacht mit besonderer Berücksichtigung der italienisch-albanischen Handelsbeziehungen”, në *Münchener Zeitschrift fuer Balkankunde* 9, Veröffentlicht von Peter Bartl [u. a]. München: Slavica, 1993, f. 9-26. (Më tej si: J. Luetić, “Die Republik ...”, f.)

⁵ Josip Luetiq, “Lundruetit detarë, marina tregtare dhe veprimtaria e porteve të Vlorës, Durrësit dhe Lezhës dhe lidhjet nautike-komerciale të shqiptarëve me dubrovnikasit në vitet 1566-1584”, në *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike 14-1984, Prishtinë: 1985, f. 111-136. (Më tej: J. Luetiq, “Lundruetit detarë ... 1566-1584”, f.)

⁶ Josip Luetić, “Moreplovci, trgovačka mornarica i lučka djelatnost Valone, Drača i Lješa i nautičko-komercijalne veze Albanaca s Dubrovčanima 1566-1586. Godine”, në *Gradska kultura na Balkanu (XV-XIX Vek)*. *Zbornik Radova* 2, (Градска култура на Балкану (XV-XIX век): зборник радова 2. Верена Хан) Uredila Verena Han. Srbska

tregtare dhe veprimtaria e porteve të Vlorës, Durrësit e Lezhës dhe lidhjet nautiko-komerciale të shqiptarëve me dubrovnikasit në vitet 1585-1599”.⁷

Kërkimet e këtij autori që zgjatën vite me radhë në fondin e pasur arkivor (Fondi “*Noleggiamenti e sicurezza*” (shkurt NOLI) të Republikës së Dubrovnikut në Arkivin Historik të Dubrovnikut - *Historijski Arhiv u Dubrovniku – AHD*), ku janë ruajtur burime me vlerë të çmueshme për historinë e jetës detare të Adriatikut dhe të Mesdheut, janë gjetur të dhëna të çmueshme për lundruesit detarë mesdhetarë dhe për plotësimin e historisë së marinave të tyre tregtare. Ai shpeshherë ndeshi nëpër dokumente ku përmenden lundrues nga Vlora, Durrësi, Lezha e Shëngjini etj., dhe gjithashtu të dhëna të shumta rreth veprimtarisë së porteve shqiptare. Duke u bazuar në këto të dhëna nxjerr konkluzionin se në të kaluarën shqiptarët kanë pasur marinën e vet tregtare, dhe se kishin një veprimtari shumë të zhvilluar nëpër portet dhe limanet e tyre, mbi të gjitha portet e Vlorës, Durrësit, dhe Shëngjinit dhe limanet e Bunës në Shkodër.⁸

Nëpërmjet hulumtimeve të tij Luetiq na jep një panoramë të qartë rreth gjendjes së detarisë të Republikës së Raguzës. Ndër të tjera Luetiq thotë, që raguzanët me anijet e tyre në shek. XVI ishin shumë aktivë në fushën nautiko-komerciale nëpër portet e Shqipërisë, të Greqisë, të Detit të Zi, të Gadishullit të Apenineve, të Afrikës Veriore, të Spanjës etj., e më tej deri në Lisbonë, Portsmouth, Marget, Londër e Hamburg etj.⁹

Më poshtë nga materiali i tij i botuar rreth marrëdhënieve shqiptaro-raguzane, që shkon mbi 100 faqe, po japim vetëm disa të dhëna kryesore, për të ilustruar deri në njëfarë mase rëndësinë e botimeve të këtij autori.

Gjatë periudhës 1570-1585, Raguzat numëronin rreth 200 anije të lundrimit tregtar që merreshin me lundrime të gjata dhe kishin një kapacitet mbartës prej rreth 66 000 tonelatash, dhe me këto anije lundronin rreth 5 000 marinarë.¹⁰ Me anijet e tyre të mëdha, që

Akademija Nauka i Umjetnosti. Balkanološki Institut, Beograd: 1988, f. 33-61. (Më tej: J. Luetiq, “Moreplovci... 1566-1586”).

⁷ Josip Luetiq, “Lundruesit detarë, marina tregtare dhe veprimtaria e porteve të Vlorës, Durrësit e Lezhës dhe lidhjet nautike-komerciale të shqiptarëve me dubrovnikasit në vitet 1585-1599”, në *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, 15/1985, Prishtinë: 1986, f. 97. (Më tej: J. Luetiq, “Lundruesit ... 1585-1599”, f.)

⁸ Po aty, f. 112; shih edhe: J. Luetiq, “Moreplovci... 1566-1586”, f. 34.

⁹ Po aty.

¹⁰ Po aty.

shpeshherë kishin një kapacitet mbartës me mbi 2 000 tonelata e që lundronin nën flamurin shtetëror të Republikës së Raguzës, por edhe ato që lundronin nën flamuj të huaj, raguzanët gjatë asaj periudhe zinin vendin e tretë në botë.¹¹ Por mund të thuhet se në Detin Mesdhe (edhe në Adriatik) me anijet e tyre tregtare të mëdha me vela e të qëndrueshme të tipit navatë dhe galion, të cilat prej anglezëve quheshin *argosy*¹², ishin të parët gjatë asaj kohe.

Luetiq bën edhe një krahasim të vogël ndërmjet shifrave të anijeve të Raguzës me ato të Republikës së Venedikut dhe me shifrat e marinave tregtare të Republikës së Gjenovës apo të ndonjë vendi tjetër. Ai arrin në konkluzionin se arsenalet e anijeve të tyre ishin më të vogla, dhe vetë Venediku kishte sa gjysmën e anijeve të tilla në krahasim me Raguzën.¹³ Pra, marina tregtare e Raguzës ishte shumë e fuqishme gjatë kësaj periudhe. Luetiq thotë se përveç anijeve që i përkisnin Republikës së Raguzës kishte ndërkohë edhe shumë raguzanë, anijet e mëdha të të cilëve ishin në shërbime tregtare të shteteve të tjera, pra nën flamuj të huaj dhe si shembull ai përmend këtu familjet Ohmuçeviqi, Tasoviqi, Mërnari, Dolistoviq-Dolist, Ivanoviqët, Ogriziq, Martolo, Mazhibradiq e shumë të tjerë.¹⁴

Veprimtaritë tregtare shënoheshin në regjistrin e noterisë së Raguzës, ku shënoheshin dhe regjistroheshin kontratat e qiradhënies ose qiramarrjes së anijeve, për sigurimin e tyre detar, dhe regjistroheshin njëkohësisht edhe sigurimet e ngarkesave në këto anije.¹⁵ Në këto veprimtari tregtare detare ndërmjet shqiptarëve dhe raguzanëve, në lidhje me ngarkim-shkarkimin nëpër porte dhe në çështjet e sigurimit detar të shumë shqiptarëve dhe të raguzanëve, të cilët ishin më së shumti lundruer detarë dubrovnikas në shërbim të fisnikëve dhe tregtarëve dubrovnikas, qenë të angazhuar shumë persona, qoftë shqiptarë, qoftë raguzanë, por pati edhe të tjerë si për shembull persona nga qyteti portual i Hercegnovit (sot në Malin e Zi).¹⁶

¹¹ Po aty.

¹² Po aty; shih edhe: J. Luetić, "Moreplovci... 1566-1586", f. 35.

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ J. Luetiq, "Lundruerit ... 1585-1599", f. 115.

¹⁶ Po aty, f. 99.

Të dhëna për portin e Vlorës dhe për konsullatën raguzane të Vlorës

Luetiq na jep të dhëna të shumta, në veçanti për portin e Vlorës. Ai thotë se anijet dubrovnikase e kishin zakon të ktheheshin në Vlorë pas lundrimesh të gjata jashtë Adriatikut, e të ndaleshin aty të paktën për një kohë të shkurtër, për t'u furnizuar me ujë, dru për djegie për kuzhinë, me ushqim dhe materiale të tjera të nevojshme për udhëtim të mëtejshëm.¹⁷ Këto furnizime duhet të kenë qenë me siguri me çmime më të ulëta se në portet e tjera të Mesdheut.¹⁸ Në qytetin e Vlorës në atë kohë vepronte me shumë sukses konsullata e përhershme e Republikës së Raguzës, e cila ka ekzistuar edhe gjatë shek. XVI. Kjo konsullatë, në radhë të parë, më së shumti është kujdesur për anijet dubrovnikase, të cilat, për herë të parë, shumë shpesh kryenin veprime portuale në portin e Vlorës.¹⁹

Kjo konsullatë i informonte dhe u jepte këshilla të çmueshme lundëtarëve dhe tregtarëve në lidhje me ecurinë dhe problemet që mund të shfaqeshin gjatë lundrimeve dhe udhëtimeve për në vendet dhe tregjet levantine.²⁰ Në Vlorë, ata furnizoheshin për udhëtimet e mëtejshme dhe kishte raste kur ata plotësonin edhe ekuipazhet në rastet kur këto ishin të paplota. E gjithë kjo punë realizohej pikërisht në saje të konsullatës raguzane të atyshme.²¹

Një listë detarësh dhe sipërmarrësish shqiptarë

Në fakt, studiuesi J. Luetiq ishte një njohës i mirë i emrave dhe i kapitenëve, i komandantëve dhe i patronëve dhe anijeve të tyre. Ai ka bërë edhe një listë të të gjithë kapitenëve të Dubrovnikut në shek. XVII, dhe nuk ka lënë pas dore pronarët e Dubrovnikut me anije me vela.²² Këto lista kanë një vlerë të madhe për historinë detare të Republikës së Raguzës.

¹⁷ Po aty, f. 102.

¹⁸ J. Luetiq, "Lundruesit ... 1566-1584", f. 132; shih edhe: J. Luetić, "Moreplovci, ... 1566-1584", f. 51.

¹⁹ J. Luetiq, "Lundruesit ... 1585-1599", f. 116.

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

²² "Glavni urednik, Memoriam Josip Luetić, Ph. D. (1920.-2005.)", në *Naše more* 52 (1-2), Dubrovnik: 2005, f. 98.

Edhe në lidhje me marinarët shqiptarë, Josip Luetiq, duke u bazuar nëpër regjistrat noterialë të Republikës së Raguzës, na jep shumë emra dhe mbiemra të kapitenëve dhe patronëve, komandantëve detarë të anijeve që kanë marrë pjesë në këto marrëdhënie. Këtu më poshtë po kufizohemi vetëm tek ata persona që ishin nga Shqipëria. Këta kapitenë dhe patronë anijesh janë një pjesë e madhe nga Vlora, por edhe nga qytetet Lezhë, Durrës, Ulqin, Shkodër etj. Kjo listë dhe të dhënat e shumta pasqyrojnë zhvillimin e marinës tregtare të këtyre porteve shqiptare. Nga punimet e tij po nxjerrim një listë²³ të këtyre kapitenëve shqiptarë:

- Apostola Caguzi nga Vlora (komandant i anijes bashkë me 10 detarë);
- lundruesi dhe ngarkuesi Andrea Jorga nga Shkodra;
- patroni Vassillo Buscali nga Vlora, komandant i gripit të vet të vogël;
- patroni Mustafa Choggia “Turco”, komandant i një gripit të vogël (“gripetto”);
- Giorgio Cusi “Greco” nga Vlora, kapiten dhe komandant i navatës së vet “Santa Maria et Evangelista”, Budac Rais, patron dhe komandant i anijes;
- J. Bula, kapiten dhe komandant i galionit “Santo Jacomo di Galitia”;
- Pernana Rais “Turco”, kapiten nga Durrësi;
- Cola Jansi, komandant i anijes së vet dhe lundrues nga Lezha;
- Antonio Greco nga Vlora, patron dhe komandant anijeje;
- Antonio Scuri nga Lezha, kapiten dhe komandant i anijes së vet;
- Francesco Elia nga Lezha, patron i barkës së vet;
- Mengo Surbi (ose Menco Sarbi) nga Shqipëria (d’Albania), kapiten komandant i fregatës së vet;
- Memi Bogda nga Shqipëria, patron i një barke;
- kapiten Liondi “da Scio”, banor i Vlorës, komandant i një gripit;
- kapiten Gjuro Jakova nga Ulqini, komandant fregate;
- kapiten Ilia Londini nga Lezha, komandant anijeje;

²³ Lista është nxjerrë nga: J. Luetiq, “Lundruesit ... 1585-1599”, f. 115-116.

- lundruesit dhe bashkëpronarët e galionit Nikolla Giansi dhe Purnana Turco, pastaj komandanti i këtij galioni Marino Greco nga Lezha;
- kapiten Iva Greco, komandant i anijes, “San Andrea” nga Durrësi;
- Tossa Bianco nga Lezha, patron barke;
- Jagni Greco patron barke nga Lezha;
- Kolenda Gregorovi patron anijeje;
- Vicko Gregorov, patron barke nga Lezha;
- Ivan Suculi, patron barke nga Lezha;
- ndërmarrësi detar Nikolla Colonsa nga Shqipëria;
- Marko Jakovlevi, patron barke;
- sipërmarrësi detar Giorgi Albanese;
- Carlo Bianco Albanese, patron barke;
- kapiten Antonio Sgurra nga Lezha;
- kapiten Giorgi Marcocci nga Lezha, komandant anijeje;
- kapiten Dino Suri Albaneze, komandant anijeje;
- kapiten Konstantin Fantacci Greco nga Vlora, komandant marciliane;
- kapiten Pervis Rais Abdullah Albaneze, komandant anijeje;
- kapiten Constantino Rais nga Vlora, komandant saete;
- kapiten Doci Bianco nga Vlora, komandant gripi;
- kapiten Mehmet Turco Albanese, komandant gripi;
- kapiten Nikolla Saragini nga Vlora, komandant gripi.

Tregtarët

Te Luetiq bie në sy edhe numri i madh i tregtarëve të mëdhenj, i lundruesve, i afaristëve detarë dubrovnikas të njohur gjatë kësaj periudhe kohore, gjë që më së miri e ilustron rëndësinë dhe sasinë e marrëdhënieve detaro-tregtare dhe lidhjet e tjera ndërmjet shqiptarëve dhe dubrovnikasve.²⁴ Këta persona më së shumti ishin fisnikë dubrovnikas, dhe madje shpeshherë përmendet edhe princi i Raguzës dhe Këshilli i Vogël i shtetit të Dubrovnikut). Kjo është periudha kohore kur Dubrovniku nevojat e veta për drithëra i plotësonte gati ekskluzivisht nga Shqipëria.²⁵

²⁴ Po aty, f. 116.

²⁵ Po aty, f. 117.

Kjo sasi e madhe mallrash tregtie, e cila mbërrinte në Dubrovnik nga portet shqiptare, nuk mund të transportohej vetëm me velanijet tregtare të Raguzës dhe me flotën tregtare shqiptare nga Vlora, Durrësi dhe Lezha, kështu që tregtarët dubrovnikas dhe ata shqiptarë merrnin me qira edhe anije të tjera e, më së shumti, dhe në radhë të parë, anijet nga Perasti, pastaj ato nga Kotorri, Budva, Risni, Hercegnovi, Korçula etj.²⁶

Siç vëren edhe Luetiq, përveç tregtarëve dubrovnikas dhe qeverisë së Republikës së Raguzës, në këtë veprimtari të gjallë e intensive detarotregtare midis shqiptarëve dhe dubrovnikasve luanin një rol shumë të rëndësishëm edhe tregtarët hebrej dubrovnikas dhe ata afaristë e tregtarë hebrej që jetonin dhe punonin në Vlorë e Lezhë.²⁷

Prej hebrejve dubrovnikas që shquheshin në këto marrëdhënie, mund të përmendet këtu Salamon Oef-i, i cili me anë të aktivitetit të tij tregtar la gjurmë të shumta në burimet arkivore të Raguzës. Salamon Oefi ishte rabin i tempullit hebraik të Dubrovnikut, pra personi më i rëndësishëm i komunitetit hebraik të Dubrovnikut.²⁸ Ai ishte një figurë jo pak e njohur e asaj kohe, pasi është autor i shumë komentimeve fetare hebraike.²⁹

Po ashtu midis tregtarëve dubrovnikas (që kanë marrë pjesë në këto marrëdhënie), në krye të tyre qëndronin bujarët dubrovnikas tok me princin dhe Këshillin e Vogël të Republikës së Dubrovnikut. Prej sipërmarrësve dubrovnikas po veçojmë Augustin (Ago) Puciqin, i cili përmendet më së shumti në këto marrëdhënie.

Krahas të tjerëve mund të përmendim këtu edhe lundërtarin e famshëm Miho Pracati, të cilit i përmendet emri më datë 20 mars të vitit 1584 në një sigurim tregtar. Në këtë sigurim përmenden edhe princi i Raguzës dhe Këshilli i Rogatëve, që sigurojnë paratë e ngarkuara në navatën e Miho Pracatit. Kjo anije duhej të shkonte në Vlorë, me qëllim që të merrte një ngarkesë drithërash për nevojat e Dubrovnikut. Siguruesit që merrnin pjesë në sigurimin e këtij udhëtimi dhe transporti

²⁶ Po aty.

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty.

²⁹ Ivana Burdelez, "La minoranza Ebraica nella storica multiculturalità di Ragusa / Dubrovnik", në *Integrazione, Assimilazione, Esclusione e Reazione etnia*, a cura di Gianfranco Giraud e Adriano Pavan. Postfazione a cura di Gianfranco Giraud, vol. II, Napoli: SCRIPTAWEB, f. 11.

ishin rreth 100 persona që të gjithë anëtarë familjesh fisnike të Raguzës.³⁰ Njëri ndër siguruesit ishte edhe vetë Miho Pracati i madh, familjes së të cilit i përkiste edhe kjo anije. Për sa i përket këtij personaliteti, ia vlen që të thuhet disa fjalë.

Miho Pracat (*1522 në Loput [Kroaci] - †20 korrik 1607 në Dubrovnik, i varrosur në manastirin françeskan të Dubrovnikut), qe ndër lundërtarët dhe tregtarët më në zë të kohës së tij. Sipas legjendës, ai e kishte nisur karrierën e tij nga asgjëja, pasi anijet e tij kishin pësuar disa herë disfatë dhe kishin përfunduar në fund të detit. Frymëzimi për t'ia nisur sërish i kishte ardhur, duke vështruar një hardhucë, e cila po mundohej t'i ngjitej murit por që ishte rrëzuar dy herë. Herën e tretë hardhuca ia doli që ta kapërcente vështirësinë dhe t'i ngjitej murit e të shkonte ku donte. Duke parë këtë zvarranik, Miho Pracat kuptoi ligjet e forcës së këmbënguljes dhe të mosdorëzimit.

Në lidhje me këtë figurë përmendet edhe një ngjarje tjetër, ku thuhet se Mihoja me anijen e tij të mbushur me drithë ishte i rrethuar nga piratë dhe ia doli që t'i shmangte e ta sillte drithin në Raguzë, për të cilin popullsia kishte kaq nevojë. Për ta nderuar për këtë gjest Mbreti Karli V e priti atë në audiencë, ndërkohë që po rruhej dhe në mënyrë provokative i ofroi atij flori dhe lavdi, por Miho Pracat, i cili ishte i zgjuar, ia refuzon ofertat me mirësjellje dhe i kërkon vetëm shaminë që mbreti e përdorte, për rroje. Kjo shami ruhet edhe sot në një muze të Dubrovnikut.³¹ Pra ky personalitet, busti i të cilit qëndron në bashkinë e Dubrovnikut ka pasur marrëdhënie tregtare me qytetet portuale shqiptare, si Vlorën, gjë që e pasqyroam edhe me shembullin e mësipërm. Këtu pra, u përmendën disa artikuj dhe botime të Josip Luetiq-it.

Autorë të tjerë

Po ashtu edhe historiani serb Vuk Vinaver ka të dhëna rreth marrëdhënieve shqiptaro-raguzane në punimet e tij.

Dr. Vuk Vinaver (*13. VII 1927-†23. VIII 1986). Për sa i përket këtij autori vlen të thuhet që iu përkushtua kryesisht historisë së zhvillimeve

³⁰ AHD NOLI, bi. 17, f. 196v-197, në J. Luetiq, "Lundruerit detarë ... 1566-1584", f. 134; shih edhe: J. Luetić, "Moreplovci, ... 1566-1584", f. 53.

³¹ Në lidhje me të dhënat biografike të mësipërme mbi Miho Pracatin, shih: Miho Pracat: URL: https://tzdubrovnik.hr/lang/de/get/spomenici/5532/miho_pracat.html (klikuar më 01.06.2022)

sociale dhe ekonomike në vendet sllave ballkanike nga shek. XIV deri në shek. XVIII, dhe nga viti 1963 deri në vdekjen e tij u mor edhe me historinë moderne – ndërkombëtare të Mbretërisë së Jugosllavisë (1919-1941).³² Gjatë hulumtimeve të tij, ai është marrë edhe me aspekte të ndryshme të historisë së Raguzës. Këtu mund të përmendim për shembull “*Dubrovačko-albanski odnosi krajem XVI veka.*”³³ (Marrëdhëniet dubrovniko-shqiptare në fund të shekullit XVI); “*Crno roblje u starom Dubrovniku od 1400-1600*” (Skllavëria e zezë në Dubrovnikun e vjetër nga 1400-1600); Monografinë “*Dubrovnik i Turska u 18. veku*”³⁴ (Dubrovniku dhe Turqia në shekullin XVIII), në të cilën ka edhe kapitull me titull “*Dubrovnik prema Bosni i Albaniji*” (Dubrovniku drejt Bosnjës dhe Shqipërisë)³⁵; më tej “*O Jevrejima Dubrovnika u XVIII veku*”³⁶ (Rreth hebrenjve në Dubrovnik në shekullin XVIII).

Në artikullin e tij me titull “*Dubrovačko-albanski odnosi krajem XVI veka.*”³⁷ (Marrëdhëniet dubrovniko-shqiptare në fund të shekullit XVI), të cilit po i referohemi në mënyrë të zgjeruar, autori Vuk Vinaver flet për një tregti të zhvilluar shqiptare gjatë kësaj periudhe dhe si pika kryesore të zhvillimit të saj ai përmend Gjirin e Drinit në Veri dhe Vlorën në Jug. Në Shqipërinë osmane, Dubrovniku blinte mallra për t’i rishitur diku tjetër, dhe për vete në Shqipëri Republika e Raguzës siguronte gjithçka që i nevojitej, prandaj importi i mallrave me origjinë shqiptare ishte shumë më i rëndësishëm se eksporti.³⁸

Vuk Vinaver përmend në studimin e tij edhe përfaqësuesit që Republika kishte nëpër disa qytete të caktuara shqiptare (në Vlorë një konsull), dhe përpiqej të ruante marrëdhënie të mira me autoritetet turke në këto qytete. Vinaver shkruan se nevoja për mallra nga Shqipëria ishte e madhe, bizneset me këtë vend sillnin fitime të mëdha, prandaj edhe tregtia ishte shumë aktive. Sipas Vinaver, në këto aktivitete, krahas pak

³² Të dhënat biografike marrë nga: Petar Kačavenda, “In Memoriam Dr. Vuk Vinaver”, në *Istorija 20*, veka 2 Institut za Savremenu Istoriju, Beograd: 1985, f. 197-198.

³³ Vuk Vinaver, “Dubrovačko-albanski odnosi krajem XVI veka”, në *Anali Historijskog instituta JAZU u Dubrovniku*, I, Dubrovnik: 1952, 1, f. 207-231.

³⁴ Vuk Vinaver, *Dubrovnik i Turska u 18. Veku*, Srbska Akademija Nauka, Beograd: 1960.

³⁵ *Po aty*, f. 25-35.

³⁶ Vuk Vinaver, “O Jevrejima Dubrovnika u XVIII veku”, në *Jevrejski almanak*, 1959/60, Savez jevrejskih opština Jugoslavije, Beograd: 1960, f. 65-78.

³⁷ V. Vinaver, “Dubrovačko-albanski odnosi krajem XVI veka ...”, f. 207-231.

³⁸ *Po aty*, f. 230.

shqiptarëve dhe disa turqve merrnin pjesë edhe tregtarë grekë dhe hebrej, të cilët e dominonin biznesin në jug të Shqipërisë.³⁹

Sasitë e drithit të cilat tregtarët dubrovnikas sollën në vend të vet, ishin mjaft të mëdha. Te këto drithëra një vend kryesor zinte gruri, i cili vinte nga Vlora dhe nga luginat veriore, të cilat ishin të ujitura mirë nga lumenjtë. Tregtia e drithit me Shqipërinë⁴⁰, sipas Vinaver, ishte aq e rëndësishme saqë me të merrej vetë shteti i Raguzës.

Megjithatë, thotë autori, pjesa më e madhe e grurit që synonte të mbulonte nevojat e Republikës importoheshin nga portet e detit Egje dhe nga Italia Jugore. Vinaver na jep sqarim edhe për mënyrën se si zhvillohej biznesi brenda ortakëve. Ai shkruan se, sipas një zakoni, të vendosur në tregtinë private, njëra nga palët siguronte kapitalin, kurse tjetra merrte përgjegjësinë për blerjet dhe shitjet dhe, pasi zbritej aksioni, fitimet ndaheshin përgjysmë.⁴¹

Në këto transaksione, një rol të dukshëm ka luajtur edhe popullsia e bregdetit malazez e cila i merrte paratë në Dubrovnik. Çmimi prej 1 hl. gruri në Dubrovnik ishte mesatarisht 60 dinarë raguzanë (d.m.th. 1,5 dukate raguzane, ose 1 temin venecian).

Përveç eksportit të drithërave nga Shqipëria, autori flet edhe për pyjet dhe lëndën drusore të vendit tonë. Republika e Raguzës, sipas Vinaver, e merrte lëndën drusore kryesisht nga rajonet e ujitura mirë nga lumi Bunë dhe lumi Drin, pra në zonat përreth Shkodrës. Krahas këtyre prodhimeve që përmendëm më sipër, Vinaver flet edhe specialitete të tjera që importonin raguzanët, si p.sh. peshk nga liqeni i Shkodrës, asfalt nga Vlora, taninë, kripë në sasi të vogla, sapun etj.⁴² Po ashtu, në artikull përmenden edhe karvanët që vinin nga brendësia e vendit e zbrisnin në portet e Shqipërisë, të ngarkuara me lëndë të para si lesh, lëkura, dyllë dhe pak mineral plumbi, të cilat më pas eksportoheshin nëpërmjet detit për në Dubrovnik. Për tregtinë e leshit Vinaver përmend edhe qytetin e Elbasanit, i cili ishte i famshëm për mbarështimin e dhive dhe të shitjes së leshit të tyre, por dhe në rrethinat e Elbasanit thotë autori, kishte shumë drithë.⁴³

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Po aty, f. 211.

⁴¹ Po aty, f. 230.

⁴² Po aty, f. 211.

⁴³ Po aty, f. 208.

Republika eksportonte në drejtim të Shqipërisë veçanërisht pëlhura të llojeve të ndryshme të cilat nuk prodhoheshin në vend: sapun, punime artizanale etj.⁴⁴ Raguzë në marrëdhëniet me Shqipërinë kishte edhe një rol tjetër të rëndësishëm, atë të riblerjes së skllëvërve. Autori thotë se qindra të burgosur, të kapur nga piratët shqiptarë⁴⁵ dhe të mbajtur në strofullat e tyre liroheshin kundrejt një shpërblimi, më së shpeshti nga ndërmjetës të shtetit të Raguzës, e cila konsiderohej si një shtet neutral. Këto pra ishin disa të dhëna nga artikulli i Vuk Vinaver, në lidhje me marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Raguzës dhe Shqipërisë gjatë periudhës osmane.

Historiani serb *Bogumil Hrabak*⁴⁶ (*1927-† 2010) është një tjetër autor, të cilit duam t'i rezervojmë një hapësirë në këtë artikull. Përveçse është marrë me marrëdhëniet shqiptaro-raguzane, puna e tij është e lidhur gjithashtu edhe me Universitetin e Prishtinës, në të cilin ishte pedagog dhe themeloi edhe Departamentin e Historisë brenda Fakultetit Filozofik. Këtë departament, ai e ka drejtuar për 8 vjet. Ai ka qenë anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Deri para vitit 1981 ai ishte pozitiv dhe i saktë, ndërsa pas këtij viti, me vendosjen e tij në Beograd ndryshon edhe qëndrim ndaj shqiptarëve. Për sa u përket punimeve të tij, të cilat përbëjnë interes për historinë tonë, po mjaftohemi vetëm me përmendjen e asaj më kryesores për shqiptarët në tre vëllime, me titull “Studime shqiptare”, I, II, III (*Arbanaške Studije*, Knj. I, II, III, Beograd: 2005). Në lidhje me punimet e shumta mund të konsultohet bibliografia e tij me titull “Jeta dhe Vepra e akademik Bogumil Hrabakut” (*Život i delo akademika Bogumila Hrabaka*⁴⁷).

Ai është marrë gjerësisht me eksportimin e drithërave nga Arbëria sidomos në shek. XIII-XVI, dhe ka botuar një artikull të gjatë me titull “Eksportimi i drithërave nga Shqipëria në shekujt XIII, XIV dhe XV”, në revistën “Gjurmime albanologjike”, nr. 1-2, të Institutit Albanologjik të

⁴⁴ Po aty, f. 211.

⁴⁵ Po aty, f. 210.

⁴⁶ Të dhënat biografike marrë nga: Esad Kurtivić, “In memoriam Bogumil Hrabak”, në *Radovi*, Knjiga XVI/2 (Historija, Historija umjetnosti, Arheologija), Sarajevo: 2012, f. 526.

⁴⁷ Dragi Maliković, *Život i delo Akademika Bogumila Hrabaka*. Međunarodni tematski Zbornik. Poseban Otišak. Kosovska Mitrovica, Universitet u Prištini (Filozofski Fakultet): 2011.

Prishtinës në vitin 1970.⁴⁸ Edhe pse punimi i tij na jep të dhëna të shumta kryesisht për periudhën e Mesjetës, sidomos për shek. XIII dhe XIV, prapëseprapë edhe për periudhën osmane artikulli i tij ka ndonjë të dhënë edhe pse të pakta. Si shembull, mund të përmendim këtu përpjekjet e Raguzës për të vendosur në vitet '90 të shek. XV marrëdhënie tregtare me Shkodrën, e cila në atë kohë ishte tashmë e pushtuar nga osmanët.⁴⁹ Në vitet 1490-1491 ata kishin filluar tashmë të importonin mel nga Buna, dhe në këmbim kishin sjellë me vete verë nga ishujt e Lastovës.⁵⁰

Një artikull tjetër i tij, i cili ka të bëjë me marrëdhëniet e Raguzës me trojet shqiptare është edhe ai me titull: “Hebrenjtë në Shqipëri nga fundi i shekullit XIII deri në fund të shekullit XVII dhe lidhjet e tyre me Dubrovnikun” (*Jevreji u Albaniji od kraja XIII do kraja XVII veka i njihove veze sa Dubrovnikom*⁵¹), për të cilin po japim disa të dhëna të shkurtra. Hrabak në këtë punim na bën të ditur ekzistencën e shumë dokumenteve arkivore rreth hebrenjve që kanë jetuar në Shqipëri dhe thotë se baza dokumentare për ta është më e madhe sesa për hebrenjtë e vendeve të tjera të Ballkanit dhe dokumentet për to në Dubrovnik fillojnë që në vitin 1281. Ai thekson se marrëdhëniet e hebrenjve të Durrësit me Dubrovnikun janë të shpeshta sidomos gjatë shek. XIV, kur ata merreshin me tregtinë e kripës dhe të tekstileve, porse në vitin 1392 me rënien e Durrësit nën sundimin e Republikës së Venedikut, hebrenjtë e këtij qyteti filluan të varfëroheshin dhe komuniteti i tyre u zvogëlua dalëngadalë derisa u zhduk krejtësisht.⁵² Pikërisht gjatë kësaj kohe fillon e merr rëndësi komuniteti hebraik i Vlorës, ku pas shek. XV, që ishte një periudhë rrëmuje për hebrenjtë, fillojnë të vijnë në Vlorë hebrenj gjermanë (ashkenaz), të cilët shpeshherë përzinin hebrenjtë e atyshëm që ishin romaniotë (greqishtfolës) dhe që kishin kohë që jetonin aty para këtyre.⁵³ Në shek. XVI u vendosën në Vlorë masa të tëra hebrenjsh që vinin nga Gadishulli Pirene, duke e kthyer Vlorën prej 4 000 banorësh në

⁴⁸ Bogumil Hrabak, “Eksportimi i drithërave nga Shqipëria në shekujt XIII, XIV dhe XV”, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 1-2, Prishtinë: 1970, f. 28-90.

⁴⁹ Po aty, f. 81.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Bogumi Hrabak, “Jevreji u Albaniji od kraja XIII do kraja XVII veka i njihove veze sa Dubrovnikom”, në *Zbornik*, 1 (Studije i građa o Jevrejima Dubrovnika), Jevrejski Istorijiski Muzej, Beograd: 1970, f. 55-97.

⁵² Po aty, f. 95.

⁵³ Po aty, f. 96.

atë kohë, me popullsi gjysmë hebraike.⁵⁴ Nga mesi e i shek. XVI e më pas, hebrejtë që emigruan aty ishin kryesisht nga Ankona dhe filluan të predominonin te komuniteti hebraik i qytetit, i cili ishte i përfshirë në konflikte të shpeshta pikërisht për shkak të këtij diversiteti të madh brenda tij.⁵⁵

Që nga viti 1520, hebrejtë e Vlorës fillojnë të bëjnë biznes, nëpërmjet detit me Dubrovnikun, dhe me Venedikun, por në mënyrë të veçantë me Ankonën. Mallrat që ata importonin ishin tekstile e gjëra të tjera të prodhuara në Perëndim. Po në këtë kohë, ata fillojnë të hyjnë në marrëveshje për eksportin e grurit nga krahina e Vlorës në drejtim të Dubrovnikut dhe shpeshherë edhe në drejtim të Venedikut.⁵⁶ Krahas kripës, artikuj kryesorë u bënë drithi, lëkura kordovane ose saftjani, dhe bitumi. Hebrejtë e Vlorës u bënë agjentë tregtarë që ndërmjetësonin me Dubrovnikun dhe vendet e tjera tregtare edhe për Maqedoninë dhe Selanikun, duke themeluar kështu një trafik të fuqishëm shkëmbimi mallrash e duke dhënë kredi me interes deri në 20% a 30%. Në këtë mënyrë, ata kishin rritur ndjeshëm blerjet e grurit për tregtarët e Dubrovnikut dhe Venecies. Malli i hebrejve nga Shqipëria pësonte në det shpeshherë edhe dëme të konsiderueshme nga piratët, dhe në radhë të parë nga uskokët, të cilët vepronin nëpër ujërat kroate.

Në dekadat e para të shek. XVI në mesin e hebrejve të Vlorës u dallua Isak Trink, i cili u bë edhe konsulli i parë i Dubrovnikut në Vlorë. Pas tij, këtë detyrë e mori nipi i tij, djali i Angelo Samuelli-t, i cili pati disa konflikte të rënda me dy eksportues të Dubrovnikut.

Në vitet gjashtëdhjetë të shek. XVI u rrit ndjeshëm edhe rëndësia tregtare e qytetit të Lezhës, ku si “konsull” u vendos një hebre nga Shkupi. Lezha u bë port i rëndësishëm sidomos për eksportin e lëkurëve dhe të leshit, të drithit të Shkupit, të drithit maqedonas dhe të Kosovës.⁵⁷ Metale gjysmë të shkrira (të përpunuara) nga minierat e Kosovës dhe shumë mallra të tjera. Rëndësia e Lezhës që rritur në mënyrë të veçantë edhe si shkak i trafikut të mallrave me Ankonën, përveç transporteve me Dubrovnikun.

Qysh prej fundit të shek. XVI, rëndësia e Durrësit fillon të rritet, së pari si port i cili shërbente edhe për importimin e tekstileve që

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Po aty.

prodhoheshin në Berat. Aty, në fillim të shek. XVI u krijua fillimisht një koloni e vogël, por tregtarët më të mëdhenj u shfaqën në Durrës vetëm në fund të atij shekulli. Kolonia më pas u zhvillua me importimin masiv të mëndafshit dhe për këtë aktivitet përmendet veçanërisht Salomon Albala.

Hebrenjtë gjatë kësaj periudhe ekzistonin me pakicë edhe në Shkodër, por këta ishin vetëm disa individë të cilët kryenin kryesisht profesionin e mjekut.

Qysh prej viteve gjashtëdhjetë e më tej (pothuajse përgjatë një shekulli të tërë) konsujt e Dubrovnikut në Vlorë furnizoheshin nga një familje hebraike e emigruar nga Ankona, e quajtur Koduto (pinjollë të së cilës ishin Jacob, Daniel, Abraham dhe Abraham i Riu).⁵⁸ Detyrat themelore të këtyre konsujve hebrenj të Dubrovnikut në Vlorë, ishin ndihmat që duhej të jepnin në blerjen e drithërave; shpengimi i skllëvërve, gjë që u kthye në fitim e në biznes edhe për shumë hebrenj të tjerë.

Hrabak, ngritjen e vërtetë të hebrenjve në Vlorë dhe në Lezhë (përveç atyre të Beratit dhe Durrësit) e lidh me periudhën pas Luftës së Qipros (1570-1573). Në Vlorë ose në lidhje me Vlorën ekzistonin një duzinë familjesh të fuqishme tregtare që kishin degët e tyre e këtu mund të përmenden familjet: Catinella, Trink, Graziano, Arah, Jahja, Hazan, Benvenisti, Maca, më pas edhe Cabillo.⁵⁹ Disa prej tyre kishin degëzimet e tyre edhe në Kostur, Berat, Lezhë, por edhe në Venecia dhe në Ankona.

Përveç atyre që u renditën më sipër, kishte edhe disa dhjetëra tregtarë të tjerë të fuqishëm që merreshin me eksportet. Vlora ushtronte një tërheqje shumë të madhe për hebrenjtë italianë dhe për këtë arsye kishte emigrime të vazhdueshme, si shembull mund të përmendet këtu viti 1591. Prodhimet kryesore të eksportit nga hebrenjtë e Shqipërisë ishin *kordovani* dhe llojet e tjera të lëkurëve që vinin nga Vlora dhe Lezha, më tej gruri dhe meli nga Vlora dhe Lezha, biskotat e Vlorës, mëndafshi i Beratit, bitumi dhe vera e Vlorës, druri gjysmë i përpunuar, vreri i lisit (“valonea”*, prej Vlore), xeherori i cili nëpër dokumente përmendet si “Terra Getta” (nga Lezha) etj. Mallrat që importoheshin ishin pëlhura e tipit karisej, sateni dhe tekstile të tjera leshi dhe mëndafshi, gëzofët e

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Po aty, f. 97.

* *Valonea* ka dy kuptime përveç *vrer lisi*, ka edhe kuptimin e një lloj mëndafshi nga Vlora.

qengjit, qelqurinat etj.⁶⁰ Çështjet financiare (sigurimet, kreditë) ishin të lidhura me transaksionet e eksportit dhe nuk kishin asnjë lidhje me kreditë e vogla të konsumatorit dhe me fajde lokale.

Deri në vitet tridhjetë të shek. XVI, hebrenjtë e Selanikut e bënë transportin e tyre nëpërmjet Vlorës. Vlora në shek. XVII, zhvillonte një aktivitet më të madh afarist sesa, për shembull, Shkupi.⁶¹ Dokumente me origjinë hebraike dhe të tjera ilustrjnë aspekte të jetës personale dhe familjare të hebrenjve të Vlorës, veçanërisht në shek. XVII.

Hebrenjve të Vlorës dhe të Lezhës nuk u erdhi fundi nga epidemitë e shpeshta dhe të dhunshme, dhe as veprimtaria e tyre e biznesit nuk mund të kërcënohej seriozisht nga pirateria dhe grabitjet në rrugët e Shqipërisë dhe të Maqedonisë. Këto komunitete hebraike u shkatërruan nga ngjarjet e Luftës Turko-Venedikase.⁶² Gjatë Luftës Turko-Venedikase të vitit 1688, hebrenjtë e Vlorës u detyruan të linin qytetin e tyre të lindjes dhe të shpërnguleshin në Berat; megjithatë, kur murtaja shpërtheu në këtë qytet në vitin 1691, ata u shpërndanë në të gjitha drejtimet. Një pjesë e të ikurve nga Vlora u larguan edhe nga Berati pas vitit 1740 dhe u vendosën në Janinë, Manastir dhe Kostur.⁶³ Këto ishin pra disa të dhëna që i shkëputëm nga përmbledhja e artikullit të sipërpërmendur të Hrabak-ut, mbi hebrenjtë e Vlorës dhe të Lezhës dhe marrëdhënieve të tyre tregtare me Raguzën.

Gjatë hulumtimeve tona gjetëm edhe punimin e diplomës së studiuesit kroat Milan Mile Cvetojević, me titull “Dy gjigantë dhe një xhuxh. Perandoria Osmane si partner tregtie me Venedikun dhe me Dubrovnikun në shekujt XVI dhe XVII” (*Zwei Riesen und ein Zwerg. Das Osmanenreich als Handelspartner von Venedig und Dubrovnik im 16. und 17. Jahrhundert*)⁶⁴ të paraqitur në Universitetin e Vjenës, në janar të vitit 2013. Ngaqë punimi paraqet një pamje të përgjithshme të politikave dhe të marrëdhënieve ekonomike të këtyre tri shteteve, si dhe përmend edhe lokalitete të Shqipërisë osmane, si Shqipërinë e Veriut, Shkodrën dhe Elbasanin, na u duk me interes ta konsultonim për

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Po aty.

⁶² Po aty.

⁶³ Po aty.

⁶⁴ Milan Mile Cvetojević, *Zwei Riesen und ein Zwerg. Das Osmanenreich als Handelspartner von Venedig und Dubrovnik im 16. und 17. Jahrhundert*. Diplomarbeit (Magisterarbeit), abgeben an der Universität von Wien. 13 Jänner 2013.

hulumtimin tonë. Lokalitetet shqiptare të sipërpërmendura citohen më tepër në kuadër të tregtisë së drithit.⁶⁵

Për lidhjet tregtaro-detare dhe marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Dubrovnikut dhe porteve shqiptare ka përmendur disa të dhëna Jorjo Tadiqi, qoftë në veprën e tij “Hebrenjtë në Dubrovnik”⁶⁶, qoftë në punimin tjetër të tij me titull “Organizimi i punëve detare të Dubrovnikut në shekullin e 16-të” (“Organizacija dubrovačkog pomorstva u XVI veku”⁶⁷).

Mbi eksportimin e lëndës së drurit të pyjeve të Arbërisë për nevojat e kantierëve të ndërtimit të anijeve në Dubrovnik në shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX është marrë kryesisht Vinko Ivančević (Vinko Ivančević) në artikullin e tij me titull “Eksportimi i drurit nga Shqipëria në Raguzë dhe ndërtuesit ragusianë të anijeve në Shqipëri në shek. XVIII e XIX”.⁶⁸

Autori në këtë artikull na jep të dhëna të shumta të nxjerra nga arkivat e Raguzës, për sasinë e drurit që nxirrej dhe eksportohej për ndërtimin e anijeve. Shqipëria importonte në shek. XVIII dhe XIX sasi të mëdha druri. Autori e vë theksin kryesisht në transportin që bëhet në Gruz të Raguzës pasi ky ishull ishte edhe kantieri detar i Republikës së Raguzës, ku prodhoheshin anijet e saj sidomos në shek. XVIII, sepse nëpër kantieret e tjera të shumta të saj si në Cavtat, Ston, Llastvo etj., bëheshin më së shumti riparime dhe pastrime anijesh të vogla, dhe rrallëherë ato ndërtoheshin nëpër këto kantiere.⁶⁹

Ndërtuesit e Gruzhit udhëtonin rregullisht në Shqipëri për të siguruar sasinë që u nevojitej, dhe për transport ata kishin pajtuar anije raguzane, por kishte raste ku në këtë transport merrnin pjesë edhe lundëtarë

⁶⁵ Po aty, f. 50.

⁶⁶ Jorjo Tadić, *Jevreji u Dubrovniku do polovine XVII stoljeća*, Sarajevo: Izd. "La Benevolencia", 1937, në f. 361 përmend konsullin dubrovnikas në Vlorë. Cituar sipas: J. Luetiq, “Lundruesit ... 1566-1584”, f. 111; shih edhe: J. Luetić, “Moreplovci... 1566-1586”, f. 33.

⁶⁷ Jorjo Tadić, *Organizacija dubrovačkog pomorstva u XVI veku*, Istoriski Časopis Istoriskog Instituta SAN, god. I, sv. 1-2, Beograd: 1949, f. 36, 40 dhe tabelat. Cituar sipas: J. Luetiq, “Lundruesit ... 1566-1584”, f. 111; shih edhe J. Luetić, “Moreplovci... 1566-1586”, f. 33.

⁶⁸ Vinko Ivančević, “Eksportimi i drurit nga Shqipëria në Raguse dhe ndërtuesit ragusianë të anijeve në Shqipëri në shek. XVIII e XIX”, në *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, II, Prishtinë: 1972, f. 103-113.

⁶⁹ Po aty, f. 105.

shqiptarë, si për shembull lundërtari nga Ulqini Hasan Zoto i cili në vitin 1781 kishte sjellë në Raguzë një barrë me dru.⁷⁰ Autori, duke u bazuar në dokumente të Arkivit Historik të qytetit të Dubrovnikut, na jep të dhëna edhe në lidhje me portet dhe limanet shqiptare ku ngarkoheshin drutë, të cilat ishin kryesisht Ulqini, limane të ndryshme në bregdetin e Durrësit, në grykëderdhjen e Erzenit (Arzenta).⁷¹ Shkodra edhe pse përmendet si importuese drurësh duket se e dërgonte lëndën e saj drusore në Ulqin, ngaqë cektësia e Bunës nuk e bënte të mundur hyrjen e anijeve të mëdha.

Për eksportin e drurit, sipas Ivançeviqit, vendosej edhe një taksë, e quajtur *gjymryk*, dhe anijendërtuesit e Gruzhit patën vështirësi në këtë temë me pashallarët shqiptarë, gjë që nuk mungoi të shqetësonte qeverinë e Dubrovnikut. Gjymryku kushtonte 4 piastra, por nuk del e qartë nëse kjo shumë paguhej për një qerre dru, apo për copë dru (trung), ngaqë këto dy masa ngatërrohen vazhdimisht. Gjymryku merrej si pagesë nga pashallarët e qyteteve si ai i Shkodrës dhe ai i Durrësit, apo pasha i Kavajës, i cili linte që kjo shumë të paguhej në Ulqin.⁷² Më vonë taksa e gjymrykut u bë më e madhe.

Ndërtuesit e anijeve nga Gruzhi, të cilët udhëtonin shpesh në Shqipëri dhe qëndronin atje për një kohë të gjatë, pas kthimit merreshin në pyetje nga qeveria në Dubrovnik, sepse ajo prej tyre merrte informacione për situatën politike dhe ushtarake në atë vend.⁷³ Qeveria e Raguzës i dërgonte ndonjëherë vetë, me mision kryesor marrjen e informacionit.

Branisllava Teneti në punimin e saj mbi përqindjet - taksat në sigurimin detar në Adriatik në gjysmën e parë të shek. XVI ka përmendur vetëm ndonjë rast të sigurimit detar nga Vlora dhe Durrësi. Për këtë periudhë ajo jep si përqindje të sigurimit detar për udhëtim Dubrovnik-Vlorë shifrat 6% dhe 10%, kurse për Durrësin 3% dhe 5%.⁷⁴

Nga Peter Bartl kemi gjithashtu edhe ndonjë të dhënë të vogël në referatin e tij të mbajtur mbi Shqipërinë për marrëdhëniet ekonomike

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Po aty, f. 111, 113.

⁷² Po aty, f. 108.

⁷³ Po aty, f. 112.

⁷⁴ Branisiava Tenenti, "Note sui tassi Adriatici d'assicurazioni nella prima metà del cinquecento", në *Studi Veneziani*, n. s. III (1979), Pisa: Giardinieditori e stampatori 1980, f. 193, 196, 198, cituar sipas: J. Luetiq, "Lundruesit ... 1566-1584", f. 112; shih edhe: J. Luetić, "Moreplovcii... 1566-1586", f. 34.

midis Gadishullit Ballkanik dhe Italisë, në Kongresin e katërt Ndërkombëtar mbi marrëdhëniet ndërmjet dy brigjeve të Adriatikut (Lanciano-L'Aquila, 13-s17.IV.1980).⁷⁵

Më tej, të dhëna të tjera të pakta, ose ku shqiptarët përmenden kalimthi si lundërtarë është edhe punimi i Veseliq Kostiq-it me titull: “Dubrovniku dhe Anglia 1300-1650” (*Dubrovnik i Engleska 1300-1650*)⁷⁶, ku thotë se “më 1619 kanë lundruar 1 067 shqiptarë në anijet venedikase të luftës në kuadrin e këmbësorisë detare”.⁷⁷

Studime të tjera

Në këtë kapitull kemi vendosur të përmendim disa tituj, të cilat kanë një rëndësi dytësore për marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe Raguzës gjatë periudhës osmane. Këtu nuk synojmë të ulim vlerën e këtyre vëllimeve dokumentare dhe punimeve, sepse ato kanë një rëndësi shumë të madhe për temat që trajtojnë, porse për objektin tonë të studimit nuk përbëjnë një rëndësi kryesore, pasi të dhënat që na nevojiten për lidhjet shqiptaro-raguzane gjatë periudhës osmane nuk janë të bollshme.

Si të parat po radhisim analet dhe kronikat e ndryshme raguzane. Këtu mund të përmend “*Anali di Ragusa del N. Ragnina*”, e cila na jep të dhëna sporadike në lidhje me objektin e hulumtimit tonë. Në fillim të shek. XVI duket se pati herë pas here edhe probleme në ujërat raguzane, të shkaktuara nga anijet osmane që vinin nga trojet shqiptare. Me sa duket këto raste ishin të lidhura kryesisht me përndjekjen e anijeve tregtare venedikase, deri brenda porteve raguzane. Megjithatë, edhe pse në këso rastesh përndjekja nuk u bëhej tregtarëve raguzanë, prapëseprapë dëme të konsiderueshme i shkakttoheshin edhe Republikës së Raguzës. Këtë na e dëshmojnë disa ngjarje të shënuara pikërisht te kronika e

⁷⁵ Peter Bartl, “L’Albania nei rapporti economici fra la penisula balcanica e l’Italia”, në *IV Congresso internazionale sulle relazioni fra le due sponde Adriatiche. I rapporti economici e commerciali*. Sotto l’Alto Patronato del Presidente della Republica. Lanciano-Chieti-Atri-Aquila, 13-17 aprile 1980. Cituar sipas: J. Luetiq, “Lundruesit ... 1566-1584”, f. 112; shih edhe J. Luetić, “Moreplovci... 1566-1586”, f. 34.

⁷⁶ Veselin Kostić, *Dubrovnik i Engleska 1300-1650*. Odelenje jezika i knjizevnosti, 26, Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, Belgrade: 1975, 660 pp.

⁷⁷ Po aty, f. 17, 60 dhe 74; shih edhe: J. Luetiq, “Lundruesit detarë ... 1566-1584”, f. 113.

lartpërmendur e N. Ragninës. Njëra i përket 13 nëntorit të vitit 1501 dhe tjetra i përket vitit 1511.

Në rastin e parë bëhet fjalë për një fustë vlonjate e cila ishte dërguar nga Vlora apostafat për të dëmtuar venedikasit, të cilëve fusta në fjalë u kapi një anije të ngarkuar me grurë, në ujërat e Raguzës. Dëmi që shkaktohet i kushton Raguzës 200 dukate, të cilat ua paguajnë turqve për të marrë anijen në fjalë. Kronika tregon më tej, se si në ndihmë të venedikasve erdhën dy fusta dhe dhe një brigantinë nga Kotorri, i cili ishte lajmëruar me anë të një korrieri, pasi kjo fustë turke ishte kthyer në një rrezik për mbarë bregun.

Mbas tri ditësh, anija turke kapet dhe sillet në arsenal, dhe turqit, të cilët me sa duket më pas u lanë të lirë, nuk deshën të lundronin më dhe u nisën nëpër tokë në drejtim të Kastelnovos, e më vonë arritën në Vlorë.⁷⁸

Ngjarja tjetër e ngjashme me të parën ka ndodhur në vitin 1511, ku një anije *biskaine* apo *buskaine* kishte ardhur në Raguzë e ngarkuar me

⁷⁸“1501. L'anno di Cristo 1501 venne a Ragusa una fusta de Turchi alli 13 di novembre, mandata da Valona apposta per dannizzar li Venetiani. Et all' alba di giorno, stando sopra lo porto, avisava una vela, fori della Croma, marziliana: andata, ebbe presa senza alcuna battaglia la detta fusta Venetiana, carga di grano. Dove Ragusei vedendo, che molti garbugli potevano incorrere per li Venetiani, per la detta marziliana, mandarono dua nobili alla fusta per poter scapularla; finalmente forno riscattati per d. 200. Fu poi richiesto el Turco intrare in porto per sigurtà loro; et intrati non forno cacciati fora con fusta, avvisando i Cattarini per uno corriere, come la fusta gran danni faceva per tutta la costa. La qual cosa veduti li Cattarini, mandorno dua fuste con uno brigentino alla presa della fusta; quali, venuti sopra el porto di Ragusa, chieseno la fusta dalli Ragusei, la quale stava nel porto, ma (Ragusei s') excusarno e damno noto alli Venetiani. E stando di fuori (Cattarini) più di 3 giorni sopra lo porto spettando, senza biscotto et vittovaglia, svilicorno molto de darli soccorso, et li Ragusei (loro) venderono 6 sacchi di pane; poi partiron alla volta di Cattaro. Et fusta de Turchi fu tirata nello arsenale; et li Turchi, non volendo navigar, andarono per terra a Castel Nuovo, poi in Valona alle stantie loro. Del detto anno, addi 15 di novembre, in Ragusa 6 imbassatori furon creati: uno per Venetia, a notificar per la fusta de Turchi; l' altro per Cattaro, per la cagione de uno naviglio preso per le galie; et altro navegò con nave Spagnole in la Valona ad Mustaibego, per la cagione della sua fusta, quale con gran fastidio accordò con esso per d. 500, et la fusta resti a Ragusei; et il quarto al gran Turco; il quinto a Napoli al vicire di Franza; il sesto allo gran capitano del re di Spagna. E tutti forno ben accettati; poi tornorno con gran honore et intento, secondo li fu data la commissione.”Annales Ragusini Anonymi item Nicolai de Ragnina, në *Scriptores*, Volumen I (=Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium. Volumen XIV, Zagabriae: Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalum, 1883), f. 271-272. (Cituar në vijim si: *Anali di Ragusa del N. Ragnina*, f.)

mallra të tregtarëve të ndryshëm. Një pjesë e këtyre mallrave qenë shkarkuar prej raguzanëve e sicilianëve në Gravozë, kurse pjesa tjetër e mallit që u përkiste venedikasve dhe parzanjotëve nuk qe shkarkuar me qëllim që të mos paguhej doganë. Anija u nis për në limanin e Malfos, ku do të qëndronin rreth 20 ditë, por aty “për fatin e tyre të keq” u sulmuan nga “turqit e Vlorës”. Këta sapo kishin marrë vesh për këtë anije qenë nisur dhe mbërritën aty me një galerë dhe 4 fuste dhe sapo hynë në limanin e lartpërmendur të Malfos gjuajtën me artileri në pìrgun e Menzes dhe luftuan kundër tyre për tri ditë me radhë. Detarët e atyshëm, të frikësuar u dorëzuan me kushte, dhe shumë tregtarë, prej të cilëve disa ishin të plagosur u lanë të lirë me ndërmjetësinë e raguzanëve.

Ata erdhën në Raguzë dhe u mjekuan me shpenzimet e raguzanëve, shpenzimet e të cilëve për këto shërbime arritën deri në një mijë dukate për dy muaj. Kurse anija me mallrat që kishin mbetur në bord e që arrinin një vlerë prej 5 000 dukatesh u dërgua në Vlorë. Vetë anija pa mallrat e sipërpërmendura vlente afërsisht 3 000 dukate.⁷⁹ E sollëm këtë fragment të plotë për shkak të rëndësisë që ka. Të dhëna të tjera më të vogla këto anale dhe kronika kanë edhe më tej, të cilat e plotësojnë kuadrin e hulumtimit tonë, por që në fakt nuk përbëjnë një rëndësi thelbësore.

Një vlerë të veçantë kanë edhe vëllimet dokumentare që mbajnë titullin “*Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*”⁸⁰

⁷⁹“*L'anno di Cristo 1511 una nave Biscaina venne a Ragusa, carica di carisie de diversi mercadanti, quali furono scarigate dalli Ragusei et Siciliani in Gravosa. Et le robe de Venetiani et bazzariotti non (si) scarigorno, per non pagar la dovana al porto, ma (essi) partiti forno al porto di Malfo, et ivi stavano da 20 giorni, dove, per la sua mala sorte, intendendo li Turchi della Valona, venseno con una galera 4 fuste, et intrati nel porto di Malfo, et scarigata la artiglieria nella torre del Menze, li dettero talmente la battaglia tre giorni continui. Per la qualcosa li marinari, sbigottiti, siresero a patti; et moltimercantifuronolassati, per intercessione de Ragusei, cosiferiti. Qualivensenoa Ragusa, et furnogovernati, curati et sanati con gran caritàallespese de Ragusei, checostò da d. 1,000 in duamesi; et vestiti, et spesati, furonspediti allipaesiloro. Et la nave con le mercantie fumenata allavoltadella Valona, con valuta de d. 5,000 et d. 3,000 chevaleva la nave.*”Anali di Ragusa del N. Ragnina, f. 275.

⁸⁰ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. I (1507-1592), përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989. (Më tej: *Dokumente, shek. XVI-XVII*, vëll. I (1507-1592), dok. nr.)

- *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. II (1593-1602), përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i

në katër vëllime të përgatitura nga Injac Zamputi.

Po ashtu të dhëna mund të nxirren edhe nga Ditarët e Marino Sanudos (*1466- †1536) (*I Diarii di Marino Sanuto*), të cilët kanë informacione të shumta për trojet shqiptare gjatë shek. XVI. Ditarët fillojnë më 1 janar të vitit 1496⁸¹ dhe mbarojnë në shtator të vitit 1533⁸² dhe përbëhen prej 58 vëllimesh. Ditarët e Sanudos kanë një rëndësi shumë të madhe edhe për çështje të ndryshme të historisë së trojeve shqiptare sidomos të shek. XVI, i cili u përket periudhave më problematike për studim, ngaqë si shekull i dytë i pushtimit, sidomos gjysma e parë e këtij shekulli është mjaft e errët. Studimi i këtyre ditarëve të shumtë kërkon kohë dhe durim, pasi Sanudo shkruan edhe në një gjuhë venedikase të shek. XVI, frazat e së cilës shpeshherë janë të vështira për t'u kuptuar dhe për t'u përkthyer.

Krahas këtyre duhen marrë në konsideratë edhe një sërë relacionesh, të cilat pasqyrojnë çështje të ndryshme dhe ngjarje brenda Shqipërisë së shek. XVI. Vlen të përmendet këtu "Relacioni Anonim"⁸³ i vitit 1570, për të cilin mendohet se është shkruar nga një proveditor i atëhershëm i Kotorrit, por që nuk i jepet emri. Në këtë relacion anonim mbi Shqipërinë përshkruhen qytetet, lumenjtë, liqenet, fushat dhe malet, dhe jepen të dhëna të ndryshme me karakter gjeografik të përgjithshëm e krahinor. Aty jepen edhe shumë të dhëna ekonomike, etnografike dhe ushtarake të

Historisë, Tiranë: 1990. (Më tej: *Dokumente, shek. XVI-XVII*, vëll. II (1593-1602), dok. nr.)

- *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. III (1603-1621), përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989. (Më tej: *Dokumente, shek. XVI-XVII*, vëll. III (1603-1621), dok. nr.)

- *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV (1675-1699), përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989. (Më tej: *Dokumente, shek. XVI-XVII*, vëll. IV (1675-1699), dok. nr.)

⁸¹ *I Diarii di Marino Sanuto*, Tomo I, Publicato per cura di F. Stefani, Venezia a Speze di Editori MCCCCLXXIX. (= I diarii di Marino Sanuto (MCCCCXCVI-MDXXXIII) dall' autografo Marciano ital. cl. VII codd. CDXIX-CDLXXVII).

⁸² *I Diarii di Marino Sanuto*, Tomo LVIII, Venezia a Speze di Editori MCMIII. (= I diarii di Marino Sanuto (MCCCCXCVI-MDXXXIII) dall' autografo Marciano ital. cl. VII codd. CDXIX-CDLXXVII).

⁸³ "Relazione dell'Albania e sue città, fiumi, monti, laghi, piani confine, ecc. Fatta l'anno 1570", në Šime Ljubić, *Starine*, Knj. XII, Zagrebu: 1880, f. 193-200; shih edhe: *Dokumente, shek. XVI-XVII*, vëll. I (1507-1592), dok. nr. 230, f. 273-288.

osmanëve, të dhëna këto të cilat mund të përdoren në saktësimin e çështjeve të ndryshme në lidhje me historinë e marrëdhënieve shqiptaro-raguzane gjatë kësaj periudhe.

Së fundi, dua të përmend edhe dy punime të tjera që në fakt janë vëllime dokumentare. Këto janë: “Shqipëria e Veriut në shekullin XVIII” (Letra të zëv. konsujve venedikas të Shkodrës), vëllimi I (1706-1756),⁸⁴ dhe “Shqipëria e Veriut në shekullin XVIII” (Letra të zëv. konsujve venedikas të Shkodrës), vëllimi II (1757-1802).⁸⁵ Vëllimet e sipërpërmendura japin raste shumë të pakta në lidhje me marrëdhëniet tregtare me Republikën e Raguzës, megjithatë bëjnë një specifikim të saktë të mallrave të ndryshme që prodhoheshin dhe tregtoheshin në atë kohë, dhe pikërisht për këtë arsye meritojnë një vëmendje të rëndësishme.

S u m m a r y

MERCANTILE RELATIONS BETWEEN RAGUSA AND ALBANIANS DURING THE PERIODE OF OTTOMAN EMPIRE SECOND VARIOUS AUTORS

First resultes

The article is a short introduction to studies on relations between Albanians and the Republic of Ragusa during the Ottoman period. It deals with papers published by various authors who have a special importance for the history of relations between the Republic of Ragusa and Albanians during the XVI-XVIII centuries. The article presents some preliminary results regarding the search. Here are presented some important authors for this study topic. Most of these scholars are Slavs, mainly Croats. Among them we can mention Josip Luetić, Vuk Vinovar, Bogomil Hrabak, Vinko Ivančević, etc. The article aims to give the main approaches the authors in question make to this topic.

⁸⁴ *Shqipëria e Veriut në shekullin XVIII (Letra të zëv. konsujve venedikas të Shkodrës)*, vëll. I (1706-1756), përgatitur për botim nga Stavri Naçi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1967.

⁸⁵ *Shqipëria e Veriut në shekullin XVIII (Letra të zëv. konsujve venedikas të Shkodrës)*, vëll. II (1757-1802), përgatitur për botim nga Stavri Naçi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1975.